



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më __. __. 2026

PROCESVERBAL

PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE TË MOSNDARJES NË LOTE TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT ME OBJEKT: "BLERJE ÇAKËLL MAKINERIE (1-100 MM) PËR RRUGËT URBANE TË BASHKISË DIVJAKË" MARRËVESHJE KUADËR ME NJË OPERATOR EKONOMIK, KU TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA, ME AFAT 12 MUAJ.

I mbajtur sot, më datë ____ . ____ . 2026, nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt: **Blerje çakëll makinerie (1-100mm) për rrugët urbane të Bashkisë Divjakë**"

- 1. Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj , me fond limit: 15,000,000 (Pesëmbëdhjetë milion) lekë pa Tvsh, e gjitha e financuar nga Granti i Bashkisë Divjakë**

Burimi i financimit: **Granti i Bashkisë Divjakë.**

Për vitin 2026: 3,333,333.33 (Tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre e tridhjetë e tre të qindat) lekë pa Tvsh, e financuar nga Granti i Bashkisë Divjakë.

Vlera e fondit limit ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte

35,102.4 (tridhjet e pese mije e njedinq e dy pike kater) euro pa tvsh .Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 15.06.2026 09:11 eshte 94.96

Për vitin 2027: 5,833,333.33 (Pesë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre e tridhjetë e tre të qindat) lekë pa Tvsh, e financuar nga Granti i Bashkisë Divjakë.

Vlera e fondit limit ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte

61,429.3 (gjashtedhjet e nje mije e katerqind e njezet e nente pike tre) euro pa tvsh .Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 15.06.2026 09:11 eshte 94.96

Për vitin 2028: 5,833,333.33 (Pesë milion e tetëqind e trdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre e tridhjetë e tre të qindat) lekë pa Tvsh, e financuar nga Granti i Bashkisë Divjakë .

Vlera e fondit limit ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte

61,429.3 (gjashtedhjet e nje mije e katerqind e njezet e nente pike tre) euro pa tvsh .Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 15.06.2026 09:11 eshte 94.96

Vlera e fondit limit ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte

157.961.2 (njëqind e pesedhjet e shtate mije e nenteqind e gjashtedhjet e nje pike dy)euro pa tvsh .Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 15.06.2026 09:11 eshte 94.96

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, neni 2 parashikohet shprehimisht se: **“Qëllimi i këtij ligji është:**

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në zbatim të neneve të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyen e mëposhtme:

Pasi kemi të bëjmë vetëm me një mall, ndarja ne lote nuk do të sillte përfitim ekonomik apo Teknik për AK,por do të rriste kostot administrative të menaxhimit dhe monitorimit të kontratave,si dhe do të sillte vështirësi në koordinimin e firmizimeve.

Për rrjedhoje mos ndarja ne lote është zgjidhja me efikase dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit.

Në VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, Kreu XI, Neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të

përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër, legjislacioni i prokurimit publik, njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte furnizimin e kërkuar, i cili nuk mund të copëzohet. Theksojmë se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që Autoriteti Kontraktor merr gjatë procesit paraprak, pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

Theksojmë se, kjo procedure, është një procedurë e cila realizohet në mënyrë të përvitshme nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Divjakë dhe për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi, si edhe referuar faktit se kemi të bëjmë me një lloj malli, ndër vite është është realizuar e përqendruar në një kontratë.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi, si edhe referuar faktit se kemi të bëjmë me një mall, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote, është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë, sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.